

V E N D I M
Nr.245, datë 22.5.1995

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe Ish të Përndjekurve Politikë dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të rriten 10 për qind të gjitha llojet e pensioneve të përfituara nga ligji nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore shtetërore të Republikës së Shqipërisë", si dhe nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me masë pensioni deri në 4000 lekë, kurse pensionet me mbi 4000 lekë bëhen me 4400 lekë.

Këtë rritje e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen me datë fillimi deri më 31.12.1995, duke përfshirë edhe këtë datë.

2. Rriten në masën 10 për qind edhe:

a) Shtesa mujore mbi pensionin e përfituar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.326, datë 21.6.1993 "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar".

b) Pensionet e caktuara sipas dekretit nr.758, datë 1.2.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut".

3. Nuk përfitojnë rritje pensioni personat që, sipas nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", nuk plotësojnë kushtet e ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore shtetërore të Republikës së Shqipërisë".

4. Masa e pensionit maksimal mbetet 4400 lekë në muaj.

5. Efektet financiare mujore për rritjen e pensioneve janë 81 milionë. Për këtë në planin e shpenzimeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore gjer më 31.12.1995 shtohen 650 milionë lekë, që përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për vitin 1995.

6. Për të përballuar punën për rritjen e pensioneve, Institutit të Sigurimeve Shoqërore i shtohen 6 milionë lekë, nga të cilët 3 milionë lekë do të përdoren për shpërblimin e punonjësve të përhershëm që do të punojnë mbi kohën normale të punës, dhe 3 milionë lekë fond pagë për aktivizimin e punonjësve të tjerë provizorë.

7. Për zbatimin e këtij vendimi dhe nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse ngarkohen Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Kursimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.5.1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi